



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1. pikën a) si dhe lidhur me nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin d) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Besim Zejnullahu” B.I. të datës 26.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 22.05.2023 të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dezinfektimi, dezintusektimi dhe deratizimi i institucioneve edukative arsimore” me nr. të prokurimit 616-23-1565-2-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Besim Zejnullahu” B.I. dt. 26.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin dt. 22.05.2023 të autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit me titull “Dezinfektimi, dezintusektimi dhe deratizimi i institucioneve edukative arsimore” me nr. të prokurimit 616-23-1565-2-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Besim Zejnullahu” B.I. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Besim Zejnullahu” B.I. (tutje “parashtruesi”) me datë 26.05.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 22.05.2023 të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dezinfektimi, dezintusektimi dhe deratizimi i institucioneve edukative arsimore” me nr. të prokurimit 616-23-1565-2-2-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Prandaj janë plotësuar kushtet për shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimi i parashtruesit janë cituar si në vijim:

- I. **Pretendimi i parë** – “OE i propozuar për kontratë ka ofruar një deklaratë që sipas të cilës OE me rastin e realizimit të kësaj kontrate , ofrimin të shërbimeve do ta bëjnë në përputhshmëri me Specifikimet teknike sipas Aneksit nr.1 por me dokumentet të cilat i ka ofruar dhe dokumentet tjera të bashkangjitura me ofertë biejnë në kundërshtim me njëra tjetrën dhe me këtë OE MONUNI vetë deklaroi se nuk i pëson kriteret e përcaktuara në Specifikimet teknike në Aneksin 1”.
- II. **Pretendimi i dytë** – “Ne dosje të tenderit të Specifikimet teknike (faqe 17)-TE DERATIZIMI Preparatet në pikat: a,b,c është kërkuar që OE të dëshmojë kopjet e Certifikatave të Analizave. OE i shpërblyer me kontratë nuk plotëson këto kriter pasiqë në dokumentet e ofruara me ofertë mungojnë Certifikatat e Analizave për produktet e cekura”.
- III. **Pretendimi i tretë** – “Ne dosje të tenderit të Specifikimet teknike (faqe 18 të pika f)-TE DEZINSEKTIMI Është kërkuar që O.E për preparatet e kërkuara për dezinfektim si në pikat d, e dhe f duhet të dëshmojë kopjet e Certifikatave të Analizave . OE Monuni nuk ka ofruar Certifikatat e Analizave për asnjë nga produktet e kërkuara për dezinfektim siq janë në pikat d, e dhe f’.
- IV. **Pretendimi i katërt** – “OE Monuni sipas dokumenteve që ka ofruar si dëshmi të posedimit të këtyre pajisjeve nuk janë të njëjta dhe një nga to që nuk plotëson kërkesat siq duhet është dëshmia për pajisjen me avull të nxehtë Vapor Kill 220W”.
- V. **Pretendimi i pestë** – “Te Folderi nr 8 Lista e pajisjeve faqe 24 OE ka ofruar Deklaratën Doganore me nr. R 12096 të lëshuar me datë 02.10.2019 paisja Vapor Kill 220W e cila nuk është sikur Deklaratat tjera Doganore të nënshkruara dhe vulosura nga shpeditori dhe le hapësirë se diqka nuk është në rregull me këtë dokument”.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 28, 51, 56, 59, dhe 69 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 02.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Për shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- B05 Njoftimi për kontratë i dt. 06.03.2023.
- B54 Formulari për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara dt, 22.03.2023.
- Dosja e tenderit, dt. 02.03.2023.
- Oferta e tenderuesit të rekomanduar “Monuni” Sh.P.K.
- B47 Letrat për sqarimin e tenderit dhe përgjigjet e AK.
- B12 Proceverbali i hapjes së tenderëve dt. 13.04.2023.
- Raporti vlerësimit të tenderëve i dt. 18.05.2023.
- B58 Njoftimi mbi vendimin e AK i dt. 22.05.2023.

Lidhur me pretendimin e parë (I) është administruar si provë fillimisht Dosja e Tenderit (tutje "DT") me ç'rast është gjetur që te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale përkatësisht kapacitetit teknik dhe profesional (9.1 & 9.2) është përcaktuar se "2. OE duhet të jap një deklaratë se i përmbahet specifikimeve teknike të përcaktuara në Aneksin 1". Tutje nga administrimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar është gjetur se operatori ekonomik në fjalë e ka dorëzuar dokumentin e kërkuar saktësisht siç është kërkuar me DT. Prandaj ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) dhe të tretë (III) është administruar si provë DT me ç'rast është gjetur që te Aneksi 1 - Specifikimet teknike të detyrueshme është përcaktuar se operatori ekonomik duhet të dëshmojë kopjet e certifikatave të analizave lidhur me preparatet e kërkuara për deratizim, dezinfektim dhe dezinfektim. Tutje nga administrimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar është gjetur se operatori ekonomik në fjalë e ka dorëzuar certifikatat e analizave ashtu siç është kërkuar me DT. Prandaj edhe këto pretendime të parashtruesit janë të pabazuara.

Lidhur me pretendimin e katërt (IV) është administruar si provë fillimisht Dosja e Tenderit (tutje "DT") me ç'rast është gjetur që te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale përkatësisht kapacitetit teknik dhe profesional (9.1 & 9.2) është përcaktuar se "3.OE duhet të dëshmojë se posedon mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që ka në dispozicion për realizimin e shërbimeve të DDD-se. Pajisjet minimale të domosdoshme për këto shërbime kërkojnë -ULV-ELEKTROSTATIKE minimumi 2 copë -ULV-elektrike minimumi 2 copë -Pompë me bateri për spërkatje minimumi 2 copë - Pajisje adekuate për dezinfektim që liron avull të nxehtë - minimumi 1 copë". Bazuar në formulimin pretendimit të parashtruesit thuhet se "një nga to që nuk plotëson kërkesat siq duhet". Me këtë rast parashtruesi thjesht pretendon se një nga dokumentet përkatëse nuk i plotëson kërkesat e DT mirëpo nuk tregon pse nuk plotësohen kërkesat e DT. Tutje nga administrimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar si dhe nga raporti i komisionit vlerësues është gjetur se tenderuesi i rekomanduar e ka plotësuar edhe këtë kriter të DT. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka arritur që të shpjegojë pse nuk është përmbushur ky kriter respektivisht me cilin veprim komisioni vlerësues cilën shkelje pretendohet që e ka bërë sipas parashtruesit. Prandaj ky pretendim i parashtruesit është i paartikulluar dhe i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimin e pestë (V) parashtruesi nuk ka treguar se me cilin veprim apo mosveprim autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me ndonjë dispozitë ligjore në fuqi. Parashtruesi thjesht pretendon se një nga dokumentet doganore të tenderuesit të rekomanduar nuk është e ngjashme me dokumentet tjera doganore të tij. Me këtë rast parashtruesi nuk ka ofruar sqarime pse këto dokumente nuk janë të ngjashme dhe aq më pak sqarime ka ofruar se për cilën shkelje mund të bëhet fjalë në këtë rast. Më tutje parashtruesi shprehet se ka dyshime për një shkelje të mundshme mirëpo as nuk tregon se ku e bazon këtë dyshim dhe as nuk tregon se për cilën shkelje dyshon konkretisht. Prandaj ky pretendim i parashtruesit është i paartikulluar dhe i pabazuar në tërësi.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 02.06.2023

Visar SHEHU



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.